

Udhëzues për Monitorimin e Tregut

Përgatitur për Departamentin e Monitorimit të Tregut në ERE

Versioni përfundimtar

Dhjetor 2017

Ky raport u mundësua nga USAID. Raporti u përgatit nga RTIInternational, nënkontraktor i Engility Corp.

Përmbledhje	7
Vështrim mbi tregun	8
Një vështrim mbi përfaqshjen ndaj monitorimit të tregut	10
Rolii ERE-s në mbikqyrjen dhe monitorimin e tregut	12
Detyrat e ERE-s sipas Ligjit për Sektorin	12
Detyrat e ERE-s sipas rregullave të tregut	13
Përputhja me Legjislacionin e BE-së	15
Parimet e monitorimit të tregut në Shqipëri	16
Tkurrrja e efekteve të një strukture monopoliste në sektor	16
Eliminimi gradual i ndërsubvencionimeve	17
Zgjedhja e mjeteve të duhura analitike për ERE-n	17
Përdorimi i gjithë burimeve të vlefshme të informacionit në lidhje me monitorimin e tregut	18
Raportimet periodike	18
Ankesat, vizitat në objekt dhe mjetet e informimit publik	18
Kostoja e ndërrimit të furnizuesit	19
Monitorimi rregullt i tregjeve konkurruese	19
Kufizimi i informacionit	20
Aspekti rajonal	20
Planifikimi kujdesshëm i burimeve	20
Udhëzimet për monitorimin e tregut	22
Monitorimi i tregut për shfaqje të sjelljeve jokonkurruese	22
Monitorimi i operatorëve të rrjetit	22
Monitorimi i përqendrimit të tregut	23
Vlerësimi i çmimit të energjisë elektrike	24
Procedurat për zbatim	25
Proçesi	25
Rregullat për zbatim nga pjesëmarrësit e tregut	26

Organizimi i informacionit për monitorimin e tregut nga ERE	
dhe vlerësimi i tij	26
Zbatimi i rregullave dhe vendosja e penalteteve	26
Përmbajtja e kërkesës për informacion në lidhje me monitorimin e tregut	28
Mënyra e mbledhjes së informacionit	28
Informacioni financiar	29
Automatizimi i monitorimit të tregut	31
Proçeset aktuale	31
Ngritja e sistemeve automatike me qëllim monitorimin e tregut	31
Proçesi i mbledhjes së informacionit	31
Si ta përpunojmë informacionin e mbledhur	32
Pengesat për marrjen e informacionit	34
Zbatimi	34
Aneksi 1: Kryerja e shërbimit të shqyrtimit të të dhënave korrente	36
Aneksi 2: Agjencia për bashkëpunimin e rregullatorëve të energjisë	69
Aneksi 3: Propozim për formatin e mbledhjes së të dhënave shtesë	81
Aneksi 4: Monitorimi i tregut nga ERE, propozohet një platformë “online” e mbledhjes dhe korrigjimit të të dhënave	112
Lista e figurave:	
8-1: Mbledhja dhe shqyrtimi i informacionit mbi monitorimin e tregut	
10-1: Vënia në zbatim e informacionit të mbledhur nga MM	
10-2: Propozim për sisteme informacioni, shqyrtimi dhe analize	

Lista e tabelave:

5-1: Parashikimet e Ligjit për sektorin që lidhen drejtpërdrejt me rolin dhe funksionet e ERE-s

A1-1: Të dhënat e OST-së Janar – Gusht 2017 (MËh)

A1-2: të dhëna periodike të OSHEE, Janar- Gusht 2017

A1-3: Prodhimi i HEC-eve të lidhura në rrjetin e transmetimit

A1-4: Grafiku i humbjeve

A1-5: Statusi i debisë

A1-6: Debitorëndaj OSHE.

A1-7: Efikasiteti

A1-8: Klientët e tensionit të ëlartë

A1-9: Shpërndaja e burimeve

A1-10: Pjesëmarrësit e tregut

A1-11: transaksionet e tregut të energjisë

A1-12: Analiza e monitorimit të tregut, përqëndrimi i tregut

Vështrim i përgjithshëm

Sipas Ligjit të vitit 2015 për Sektorin e Energjisë në Shqipëri (Ligji Sektorit të Energjisë), ERE (Rregullatori i Energjisë) ka një rol vendimtar në mbikqyrjen e efektshmërisë së tregut të energjisë, si për sa i përket objektivave që duhet të arrihen gjatë ushtrimit të funksionit të rregullimit, ashtu edhe kryerjen e detyrave të veçanta.

Sipas nenit 18 (1) të Ligjit, objektivat e ERE-s si rregullator përfshijnë:

Promovimin e një tregu konkurrues vendas për gjithë klientët dhe furnizuesit, përkushtimi në zhvillimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues rajonal si dhe shmangia e pengesave në tregtimin e energjisë me vendet anëtare tëBE, inkurajimi i konkurrencës së ndershme dhe mbrojtjen e konsumatorit, duke bërë të mundur që klientët të përfitojnë nga mirëfunksionimi i tregut vendas.

Neni 22 kërkon nga ERE të monitorojë nivelin e hapjes së tregut si dhe funksionimin e konkurrencës, sinë tregun me shumicë, ashtu edhe në atë me pakicë, duke përfshirë bursat e energjisë, çmimet, kostot e ndërrimit të furnizuesve, kostot e zgjidhjes së kontratës si dhe çdo shmangie apo pengesë e konkurrencës si dhe informacionit që ka të bëjë me të, si dhe referimin e këtyre rasteve tek autoriteti i konkurrencës.

Të Hënën, e datës 13 Nëntor 2017 konsulentët David Lockhart dhe Aleksandër Golas nga RTI International, nënkontraktor i Engility Corp. vizituan Tiranën për një periudhë një javore. Një nga qëllimet e kësaj vizite ishte t'i jepte një shtysë përpara ndërgjegjësimit të ERE-s për rolin që ajo ka në kryerjen e funksionit të saj në monitorimin e tregut, si ç'përcaktohet në ligj dhe akte të tjera.

Është mundësuar gjithashtu trajnimi i Drejtorisë së Monitorimit të Tregut në ERE, nëpërmjet një procesi transparent të shkëmbimit të mendimeve. Ky draft final i udhëzimeve për monitorimin e tregut përfshin konkluzionet e një takimi dyditor me drejtorinë e Monitorimit të tregut ndërmjet datave 13 – 18 Nëntor 2017 si dhe mbështetet nga një set i plotë të dhënash të rishikuara që mund të ndihmojnë në mbledhjen e të dhënave për monitorimin e tregut (shiko Anekset 1 – 3).

Këto udhëzime për monitorimin e tregut janë bërë në mënyrë të tillë që të vënë në pah funksionet e ERE-s si dhe mënyrat se si t'i ushtrojë ato.

Anekset bashkangjitur janë forma të gatshme që do ndihmojnë ERE-n në mbledhjen e të dhënave si dhe një draft propozim që ERE të mundësojë mbledhjen e të dhënave “online” si dhe sistemin e saktësimit të tyre.

Përmbledhje

Ky raport vë në dukje, pas diskutimeve dhe dakortësisë me ERE-n, një propozim për sa i përket përjasjes ndaj ngritje së një sistemi të monitorimit të tregut, si dhe monitorimin e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike në sektorin e shërbimeve të licensuara nga ERE.

Ky raport është pjesë e asistencës teknike dhënë ERE-s nga RTIInternational me financimin e USAID në emër të programit të rritjes së kapaciteteve për strategjinë e zhvillimit ECLEDS).

Më në hollësi, ky raport organizohet në kapituj dhe sektorë që përshkruajnë:

1. Njohja dhe këndvështrimi që konsulenca ka për situatën që ERE ka për sa I përket tregut të energjisë elektrike në Shqipëri;
2. Pasqyrim I përjasjes së propozuar për kryerjen nga ERE të monitorimit të tregut si dhe hapat e nevojshëm që do të ndërmerren në këtë proces;
3. Roli që ka ERE-s si monitorues tregu, rol që është caktuar jo vetëm me Ligj (ligji për sektorin), por edhe në rregullat e tregut si dhe më gjerë në rajon në kuptim të kërkesavë të BE-së në lidhje me kërkesat e hyrjes (në treg).
4. Parimet që duhet të përfshihen në rregullat e tregut.
5. Udhëzimet e duhura për vendosjen e përgjegjësive të monitorimit të tregut, si ç'mund të jenë mjetet e identifikimit të sjelljeve jokonkurrese apo shtrembërime të çmimit;
6. Aspekte të vendosjes së monitorimit, duke përfshirë proceset e nevojshme, kërkesat rregullatore që u imponohen pjesëmarrësve të tregut, organizimi brendshëm dhe strukturimi i funksionit të monitorimit të tregut në ERE dhe rregullat për zbatimin e tyre.
7. Anekset e formave të gatshme si dhe një draft propozim që ERE të mundësojë mbledhjen e të dhënave “online” si dhe sistemin e saktësimit të tyre.

3. Vështrim mbi tregun

Në fillim të viteve '90, Shqipëria gëzonte tepriçë të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike. Gjithësesi, në sajë të zhvillimit të shpejtë të vendit pas daljes nga e kaluara komuniste si dhe rritjes së shpejtë të konsumit kryesisht në sektorin familjar, në krye të një dekade kjo tepriçë e kapaciteteve gjeneruese u kthye në mungesë. Kështu filloi importi në masë të energjisë elektrike,

me mbështetjen e fortë të Qeverisë. Kjo gjendje deficiente ishte e përhershme dhe agravohej kryesisht në vitet e këqinj nga pikëpamja hidrologjike (vitet e thatë), shpeshherë duke rrezikuar edhe buxhetin e vendit.

Pikërisht për këto arsye tregu i energjisë elektrike në Shqipëri është nënshtruar një sërë reformave strukturore në 10 vitet e fundit.

Së pari, në përputhje me politikat e Shqipërisë sa i takon aderimit në BE si dhe të afrimit me komunitetin e energjisë në Europën Juglindore, u krye ndarja e transmetimit dhe shpërndarjes nga prodhimi, duke pranuar që ndarja nga aktivitetet e tjera është hapi i parë i thithjes së investimeve private në kapacitetet gjeneruese.

Së dyti, për sa i përket prodhimit, është ndjekur një politikë e tërheqjes së investimeve më të mëdha private kryesisht në burimet e rinovueshme të energjisë, gjë që rezultoi në rritjen e ndjeshme të sektorit të HEC-eve të vegjël. Një masë e madhe e këtyre investimeve është kryer nga anëtarë të diasporës shqiptare dhe investitorë të tërhequr nga suksesi i këtij aktiviteti.

Shqipëria privatizoi gjithashtu dhe shpërndarjen dhe ÇEZ, një Shoqëri private që operon në sektorin e shpërndarjes së energjisë elektrike në Çeki. Ishte për pak kohë pronar i OSSH-së. Dështimi për ta përmirësuar gjendjen si dhe vlerësimi kritik i aktivitetit të ÇEZ përfundimisht bëri që Qeveria Shqiptare të rimarrë kontrollin e Shoqërisë dhe periudhës së menaxhimit të OSSH-së nga një Shoqëri private i erdhi fundi.

Për momentin sektori është i pandarë, dhe tarifat e operatorëve kryesorë miratohen nga ERE mbi baza vjetore, sidomos tarifat e klientëve fundorë mbikqyren rreptësisht nga ERE.

Për shkak të pamundësisë së tërheqjes më tej të investitorëve të huaj privatë si dhe duke patur akses në burime alternative energjie nëpërmjet përqasjeve tradicionale, politika e Qeverisë tashmë është që të tërheqë investime nëpërmjet ngritjes së bursës së energjisë duke i mundësuar sektorit një treg konkurrues.

Bursa Shqiptare e energjisë do të mundësojë rritjen e konkurrencës ndërmjet prodhuesve dhe furnizuesve, kryesisht nëse Shoqëritë jashtë Shqipërisë (Kosova apo shtete të tjera Europiane) lejohen gjithashtu të konkurrojnë pa pengesa. Kjo do të mundësojë gjithashtu çmimin e vërtetë të energjisë elektrike në Shqipëri, siç e vendos tregu. E për rrjedhojë duhet t'i mundësojë ERE-s të vazhdojë miratimin e tarifave si dhe politikat e reformave në këtë sektor.

Vendosja e një tregu të hapur, transparent dhe konkurrues të energjisë elektrike kërkon monitorim të kujdesshëm nga ana e rregullatorit me qëllim zhvillimin e duhur të politikave rregullatore dhe t'i kontrollojë ato në mënyrë të tillë që të mundësojë shmangien e pengesave për një funksionim efikas të tregut.

Një vështrim mbi përqasjen ndaj monitorimit të tregut

Ky kapitull na jep një vështrim mbi përgjegjësitë e ERE-s në funksion të monitorimit të tregut. Gjerësisht, elementët kyç janë si më poshtë:

1. Identifikimi i përgjegjësive të veçanta që Ligji i sektorit I jep ERE-s në lidhje me mbikqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike (si atij me shumicë, ashtu edhe atij me pakicë) si dhe llojet e veprimtarive të cilat ERE duhet t'i ndërmarrë;
2. Gjetja e informacionit të nevojshëm nga ERE, në mënyrë që të kryejë funksionet për secilin aktivitet, p.sh:

Çfarë informacioni do të kërkohej nga ERE me qëllim vlerësimin e funksionimit efikas të tregut, si atij me shumicë, edhe atij me pakicë, si në terma afatshkurtër, ashtu edhe në ato afatgjatë;

Si do të mundet ERE ta marrë një informacion të tillë (raportet periodike egzistuese, rregulla të reja apo ndonjë lloj tjetër mbikqyrjeje të zhvillimeve në treg)?

Si mundet që proceset e mbledhjes së të dhënave, analizave të jenë më efektive dhe të shpejta (automatizim pjesor i procesit)?

A do të përqëndrohet mbikqyrja e ERE-s në tregun me shumicë të ditës në avancë dhe tregun balancues apo në furnizimin me pakicë të klientëve familjare? Ndërsa në tregjet në zhvillim pjesa që zë tregu I ditës në avancë, në fillim nuk është e ndjeshme, mbikqyrja e abuzimeve në treg nga lojtarët kryesorë, si rrjedhojë abuzimi me çmimin e klientëve fundorë përbën shqetësimin kryesor.

3. Strukturimi i monitorimit të tregut apo shqyrtimi i informacionit të mbledhur në mënyrë të tillë që t'i mundësojë ERE-s t'u përgjigjet pyetjeve të rëndësishme mbi politikën e tregut të energjisë elektrike si:

A garantohet siguria e sektorit? (në mënyrë të veçantë politika e mbajtjes së kolateralit a mjafton për të garantuar sigurinë apo në fakt dëmton zhvillimin e tregut nëpërmjet pengesave të panevojshme?)

Përkufizimi i produktit të tregut të ditës në avancë a mjafton për adresimin e nevojave të klientëve në Shqipëri apo rajon? (A do ta lejojë ky përkufizim Shqipërinë të zbatojë deri në fund politikën e bashkimit të tregut?)

A mos nevojitet të orientohemi drejt një tregu ditor apo tregu financiar në fushën e energjisë elektrike?

A është i mjaftueshëm numri i furnizuesve të pranishëm në treg? (a hyjnë furnizuesit në marrëveshje me njëri tjetrin me qëllim përqëndrimin e tregut dhe shmangien e konkurrencës në kurriz të klientëve fundorë?)

4. Vendosja e kriterëve të raportimit. Sapo të identifikohen nevojat si dhe mënyrat e mbledhjes së informacionit, vendoset se cilat subjekte do të duhet të paraqesin të dhëna, kur dhe kujt? Sa transparente duhet të jenë/ Kush duhet t'i aksesojë këto të dhëna? Si do të përdoren këto të dhëna? Si do të ndikojë pozitivisht krijimi i një baze të dhënash online për gjithë drejtoritë e ERE-s (liçensimi, tarifat, monitorimi i tregut) në performancën e ERE-s.
5. Zbulimi i mjeteve dhe proceseve analitike që do të përdoren për përpunimin e të dhënave. P.sh: për të gjykuar në lidhje me efikasitetin e tregut, egzistojnë mjete analitike që mund

të përdoren si për tregun me shumicë, ashtu edhe për atë me pakicë, si në SHBA ashtu edhe në Europë, si Indeksi Herfindahl – Hirschman (HHI) ose koeficientët k-firm.

6. Zhvillimi i një plani sistematik për kryerjen e analizave dhe zbatimin e përgjegjësive që Ligji për sektorin i ngarkon ERE-s.
7. Përcaktimi i burimeve njerëzore dhe aftësive të tyre. Minimalisht dy anëtarë të stafit duhet të trajnohen që të zhvillojnë monitorimin e tregut. Ata duhet të krijojnë sistemet e nevojshme për kryerjen nga ana ERE të funksionit të saj të monitorimit të tregut.
8. Sigurojnë burimet e nevojshme si dhe zbatojnë planin e hartuar për këtë qëllim.

Konsulentët e RTI asistuan ERE-n në zbatimin e përgjegjësive të saj në lidhje me monitorimin e tregut në këtë mënyrë:

Prezantuan dhe, aty ku ishte e nevojshme spjeguan udhëzimet e përmbledhjes së monitorimit të tregut drejtorisë përkatëse të ERE-s, duke përfshirë përshkrimin e hapave të përshkruar deri më tani apo atyre që do të përshkruhen më tej në këtë material;

Mundësuan trajnim për stafin e monitorimit të tregut në ERE në lidhje me këto çështje

Asistuan në hartimin dhe ndryshimin e informacionit shtesë të kërkuar në diskutimet e bëra në lidhje me këtë temë.

Rolii ERE-s në monitorimin dhe mbikqyrjen e tregut

Ky kapitull flet për bazat ligjore mbi të cilat ERE kryen monitorimin e tregut. Ka disa përcaktime ligjore sipas të cilave ERE ka tagrin për të kryer një rol të tillë. Përveç Ligjit të

sektorit si dhe rregullave të tregut, Rregullores së BE (Nr. 1227/2011) të Parlamentit dhe Këshillit të Europës të 25 Tetorit 2011 për Integritetin dhe Transparencën e tregut me Shumicë të energjis, megjithëse ende e paplikueshme për Shqipërinë, adreson çështje tëintegritetit të tregjeve dhe rekomandon një bazë legislative që parandalon abuzimet në treg.

Detyrat e ERE-s sipas ligjit për Sektorin:

ObjektiviI përgjithshëm I të pasurit të një sistemi të monitorimit të tregut si dhe të raportimit në ERE të të licensuarve është t'i mundësojë ERE-s të kryejë detyrat e saj si ç'parashikohen në ligjin për sektorin. Parashikimet t këtij Ligji (tabela 5 – 1) ka të bëjë direct me mandatin dhe detyrat që ERE duhet të kryejë në këtë drejtim:

Tabela 5-1: Parashikimet e Ligjit për sektorin të lidhura direct me tagrin dhe funksionimin e ERE-s:

Nenii Ligjit	Fusha e zbatimit	Mbikqyrja dhe funksionet e ERE-s në lidhje me tregun
18/1/f	Rolii ERE-s	Sigurohet që klientët perfitojnë nga funksionimi eficient I tregut vendas, promovojnë konkurrencën reale dhe mbrojtjen e konsumatorit.
19	Detyrat e ERE-s	Sigurohet të shmangë ndërsubvencionimin ndërmjet aktiviteteve të transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit si dhe atë ndërmjet kategorive të ndryshme të klientëve; Bashkëpunon me Autoritetin e Komkurrencës si dhe autoritetin mbikqyrës të tregut në shqyrtimin e rasteve të sjelljeve jokonkurrese apo ndonjë aktiviteti tjetër të pjesëmarrësve të tregut;
22	Monitorimi nga ERE	Vendosja e rregullave të tregut të energjisë elektrike Zbatimi nga të licensuarit I parimit të transparencës NuveliI hapjes së tregut dhe efektivitetiI konkurrencës si në nivelet e tregtimit me shumicë, ashtu edhe në ato me pakicë, apo në bursat e energjisë Çmimet për klientët ku përfshihen sistemet e parapagimit, tarifat e ndërrimit të furnizuesit, tarifat e ndërprerjes së kontratës si dhe kostoja e mirëmbajtjes Ankesat nga klientët Shmangia apo kufizimiI konkurrencës apo ndonjëinformacion I ngjashëm PrezantimiI problemeve tek autoritetet e konkurrencës Lidhja e kontratave kufizuese që perfsihin ato me kusht, të cilat mund të pengojnë klientët e mëdhenj jofamiljarë të lidhin kontrata me më shumë se një furnizues njëkohësisht, apo të ndalosh zgjedhjen e tyre për të vepruar në këtë mënyrë. Vendosja e rregullave në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e OST-së; OSSH-së; furnizuesve, klientëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në treg; BashkëpunimiI OST-së me TSO-të e tjera fqinje apo rrjetin European të transmetimit të energjisë Vendosja e rregullave për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve nëinterkoneksion Menaxhimi kapaciteteve të kufizuara në rrjetin e transmetimit , përfshirëinterkonektorët si dhe vendosja e menaxhimit të kapaciteteve të kufizuara; Publikimi nga TSO iinformacionit të duhur në lidhje me interkonektorët, përdorimin e rrjetit dhe alokimin e kapaciteteve për palët e interesuara.
24	Zgjidhja	Vepron si arbitër në rast të mosmarrëveshjeve ndërmjet klientëve dhe të

	mosmarrëveshjeve	liçensuarve apo ndërmjet vet të liçensuarve
53	Operatorii Sistemit të Transmetimit (OST)	Liçenson TSO
57	Operatori i Tregut (OT)	Miraton liçensën e OT
106	Hetimi administrativ	Në rast shkeljesh të veçejtura fillon hetimin administrativ
107	Kundravajtjet administrative	Vendos gjopa ndaj të liçensuarve

Detyrat e ERE-s sipas rregullave të tregut:

Përveç Ligjit egzistojnë edhe akte të tjera nënligjore që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë trajtojnë rolin e ERE-s si monitorues tregu, si ç'janë:

Rregullat për transparencën në sektorin e energjisë elektrike, vendosja e rregullave të detajuara në lidhje me kërkesat për informacion në OST, OSSH, prodhuesit dhe konsumatorët.

Rregullat e tregut që, në kapitullin e dytë, përveç të tjerash sanksionojnë që ERE:

Është përgjegjëse për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të pjesëmarrësve të tregut si dhe të mbikqyrë nga pikëpamja rregullatore tregun Shqiptar të energjisë elektrike (1.1).

Monitoron në mënyrë të vazhdueshme tregun e energjisë elektrike për të bërë të mundur funksionimin e tij efikas dhe joabuzues si dhe mbrijtjen e konkurrencës ndërmjet pjesëmarrësve (1.3)

Në kryerjen e këtij roli duhet të kontrollojë çmimet monopolistike, abuzimet në treg, vendosjen e rregullave dhe lehtësimin e konkurrencës (1.6).

Qëllimi kryesor i ERE-s në shqyrtimin e të dhënave financiare të të liçensuarve është të sigurohet se të liçensuarit kanë burime financiare të mjaftueshme për të kryer me sukses aktivitetin për të cilin janë liçensuar si dhe t'i menaxhojnë me kujdes këto burime financiare me qëllim garantimin e një shërbimi të sigurt, të përballueshëm, të besueshëm dhe cilësor, duke plotësuar kështu nevojat e tashme dhe në vazhdim të klientëve të tyre.

Njëkohësisht, ERE duhet të sigurohet për ndalimin e sjelljeve monopolistike që rezultojnë në kosto shtesë për klientët, apo dhe në rast se I konstaton, të arrijë t'i ndërpresë ato menjëherë. Një fokus i veçantë kushtohet sjelljes dhe politikave të Shoqërive që operojnë rrjetin, pasi shpeshherë këto janë kyçi që mundëson konkurrencën e lirë. Kërkesat pa lidhje apo të egzagjeruara të operatorëve të rrjetit tejzgjasin afatet e vendimmarrjes në lidhje me aprovimin e pikave të lidhjeve, kostove të larta të lidhjeve, përdorimit apo aksesit në rrjet janë faktorë që pengojnë konkurrencën. Nga diskutimet me ERE-n treguan që ata I kuptojnë dhe pranojnë këto detyrime.

Në mënyrë më specifike, përpjekjet e ERE-s për monitorimin e tregut duhet t'i bëjnë të liçensuarit të tregojnë që:

Ofruesit e shërbimeve duhet të kenë aftësinë e duhur financiare për të kryer aktivitetin (plotësimin e gjithë detyrimeve kontraktuale) si dhe të kryejnë investimet që ata shohin të arësyeshme.

Ndërkohë, monitorimi i tregut duhet të fokusohet në analizën e ndalimit të pozitive dominuese në treg si dhe aksesin në segmente tejet të leverdisshme të tregut të mos bllokohet nga operatorët e rrjetit apo pjesëmarrësit e tregut.

Lind gjithashtu nevoja për një vlerësim të tregut me shumicë të ditës në avancë si dhe atij balancues, Brenda orëve të ditës apo vendndodhjeve.

Monitorimi i numrit të furnizuesve në treg si dhe ndonjë përpjekje e tyre për t'u përqëndruar.

Në varësi të aktivitetit për të cilin është licencuar, monitorimi i tregut, në sajë të të dhënave operative duhet t'i vijë në ndihmë ERE-s në drejtim të asaj që çdo licencuar të funksionjë në mënyrën sa më efektive dhe efikase të mundshme. Në mënyrë të veçantë, parametrat e raportimeve operacionale duhet të përmbushin kritere të tilla si:

Disponueshmërinë e sistemit (të rrjetit apo të sistemeve të transportit)

Shpejtësia dhe lehtësia e lidhjes në rrjet

Terma kontrate të drejta dhe të arësyeshme

Niveli i ndërrimit të furnizuesit nga klienti (një vlerësim nëse klientët mund të ndryshojnë lehtësisht furnizues, apo të identifikohen arësyet që mund ta pengojnë një proces të tillë)

Qëndrueshmëria e sistemit matur me numrin e difekteve, rënive apo ndërprerjeve, kryesisht ato që pengojnë gjeneruesit për të çuar energjinë tek klientët

Menaxhimi i shërbimit ndaj klientit, ku përfshihen standarte të tilla si numri i ankesave si dhe koha e trajtimit të tyre.

Monitorimi i humbjeve në rrjet si dhe efikasitetit të mbledhjes së të ardhurave duke garantuar të ardhura të vazhdueshme në sektor

Cilësia e energjisë së furnizuesit tek klientët familjarë

Çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë në punë

Përputhja me legjislacionin e BE-së:

Aktualisht Shqipëria ndodhet në procesin e vendosjes sënsimës së BE-së së përfitimit në komunitet (acquis communautaire) në sektorin e energjisë elektrike. KE ka vendosur tashmë legjislacionin e përshtatshëm si dhe Agjensia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) vendos rregullat për të mundësuar funksionimin efikas të tregjeve të energjisë elektrike, veçanërisht duke krijuar rregulla që shmangin pengesat për një konkurrencë ndërkufitare.

Më e përshtatshme për ERE-n në funksion të kryerjes së monitorimit të tregut naga ana e saj, është rregullorja 1227/2011 e Parlamentit European dhe këshillit e 25 tetorit 2011 në lidhje me integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë elektrike, rregullore e cila, ndërmjet të tjerash paraqet kriteret për kryerjen e monitorimit të tregut si dhe detyrimin për të bashkëpunuar me autoritet e konkurrencës apo rregullatorët e tjerë, si Brenda ashtu edhe jashtë vendit , dike përfshirë ACER-in në rolin e mbikqyrësit të tregut. Nga ana e saj, ACER paraqet raporte vjetore në lidhje me monitorimin e tregut, të cilat mund të jenë të dobishëm në lidhje me vendosjen e një forme të përgjithsme monitorimi në vazhdim nga ERE.

Egzistojnë gjithashtu direktiva apo rregullore të tjera të BE-së si rregullorja e komisionit Nr. 543/2013 e 14 Qershorit 2013 për marrjen dhe publikimin e të dhënave në tregjet e energjisë si dhe amendimin e aneksit 1 të rregullores Nr. 714/2009 të Parlamentit Europiandhe të Këshillit. Kjo rregullore përcakton minimumin e të dhënave që kanë të bëjnë me prodhimin, transmetimin dhe konsumin e energjisë elektrike që u vihet në dispozicion pjesëmarrësve të tregut. Ajo bën gjithashtu të mundur që mbledhjen dhe publikimin e datave nga një qendër si ç'është Rrjeti European i Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit të energjisë elektrike. Ndërmjet të tjerash, është vendosur detyrimi që në mënyrë të rregullt dhe periodike të mblidhen dhe publikohen këto të dhëna:

- Asetet gjeneruese
- Sasia e elementëve të ndryshëm të rrjetit apo infrastruktura e rrjetit të transmetimit, duke përfshirë atë ndërkufitare.
- Mungesa e aseteve të mëdha në rrjet, kryesisht nga ana e konsumatorëve
- Parashikimii rezervave të fitimit parë në një perspective me baza vjetore
- Menaxhimii kongjestionit
- Tregu balancues.

Parimet e monitorimit të tregut në Shqipëri:

Ky kapitull përshkruan se çfarë duhet të bëjë ERE si dhe mjetet që duhen:

Bazuar në informacionin e marrë nga pjesëmarrësit e tregut apo nga shqyrtimi i kontratave

Vëzhgimi i sjelljes?

Të tjera? Fuqia në treg e cila nuk përmendet në Ligjin për sektorin

Çfarë analize kërkohet nga ERE apo pjesëmarrësit në treg?

Shqetësimi i rregullatorit në lidhje me fuqinë e Shoqërive për të ofruar energji elektrike në mënyrë efikase dhe efektive ka të bëjë me rëndësinë e këtyre shërbimeve në mbarëvajtjen e aktivitetit ekonomik në përgjithësi. Ky kapitull fokusohet në disa prej parimeve kryesore që ERE duhet t'u përmbahet për monitorimin e tregut në Shqipëri.

Tkurrja e efekteve të një strukture sektori të monopolizuar

Tregu i energjisë elektrike në Shqipëri është praktikisht i monopolizuar në çdo aspekt:

Ka vetëm një Shoqëri shpërndarjeje të energjisë elektrike. Ndërsa mund të justifikohet prania e vetëm një shpërndarësi në një treg (dhe territor) të vogël si Shqipëria, kjo e bën më të vështirë për ERE-n të gjejë baza krahasimi.

Prodhimi i energjisë dominohet ndjeshëm nga KESH, i cili, përveç statusit të tij monopolistik, përmban kryesisht burime hidrologjike gjeneruese. Një portofol i tillë gjenerimi zvogëlon më tej mundësinë konkurruese si dhe varet ndjeshëm nga kushtet sezonale atmosferike. Për më tepër, shumica e prodhimit potencial në Shqipëri, jo vetëm e KESH, (RES) është kontraktuar tani për periudha afatgjata nëpërmjet kontratave dypalëshe, duke lënë kështu një hapësirë tepër të kufizuar të gjenerimit për në tregun e lirë.

Lidhja me sisteme të tjerë është e rrallë, por në këtë drejtim situata po përmirësohet.

Është pikërisht për këto arsye që ERE, në funksion të monitorimit të tregut duhet veçanërisht të përqëndrohet në mundësimin e një funksionimi efikas të tregut vendas, ku të jenë garantuar konkurrenca efikase apo mbrojtja e konsumatorit (neni 18/1/f dhe 22 i Ligjit).

Kjo kërkesë aplikohet kryesisht për të minimizuar efektin e një sektori prodhimi gjërësisht monopolistik si dhe bërjen për aq sa është e mundur të ngritjes së kapaciteteve prodhuese të pavarur nga KESH (ku përfshihen edhe ata prodhues të gatshëm nëpërmjet interkonektorëve).

Eliminimi gradual i ndërsbvencionimeve:

Një zonë tjetër ku funksionet e monitorimit të tregut duhet të ështrihen është edhe eliminimi i ndërsbvencionimeve nga pjesëmarrësit e tregut (neni 19 i Ligjit). Ky aspekt është i rëndësishëm

në lidhje me sektorin e subvencionuar familjar (konsumi i të cilit vetëm njihet rritje, ndaj presioni nga kostoja e ndërsbvencionimeve ka gjasa të rritet më tej, për sa kohë do të zbatohen të njëjtat politika). Shmangia e ndërsbvencionimeve indirekte apo ndonjë shtrembërim tjetër i tregut përbëjnë politikat bazë të BE-së dhe KE-së.

Zgjedhja e mjeteve të duhura analitike për ERE-n.

ERE-s i nevojitet të dallojë hapësirat për të ndërhyrë në radhë të parë duke u nisur nga qëllimi bazë që përcakton Ligji për sektorin. Këto aktivitete ndahen në disa kategori si p.sh:

- Një lloj ndërhyrjeje mund të ishte nëpërmjet vendosjes së disa rregullave dhe objektivave si çdo të mund të propozoheshin nga operatori i tregut apo ai i sistemit. Në veçanti planet e zhvillimit të rrjetit (p.sh: për të shmangur mbingarkesën në linja, që nga prodhuesi deri tek përdoruesi si dhe duhet të shqyrtohen planet e zhvillimit për interkoneksionet. Rregullat e aksesit në rrjet duhet të jenë të tilla që të mundësojnë trajtimin jodiskriminues të pjesëmarrësve në treg dhe efektin që ato japin në inkurajimin apo ndalimin e efikasitetit të tregut.
- Një lloj tjetër aktiviteti do të ishte monitorimi i tregut, deri ku ai është konkurrencës. ERE mund gjithashtu të vendosë nëse çmimet e tregut janë të arësyeshme (duke parë përfitimet e pjesëmarrësve të tregut apo duke bërë krahasimin me “benchmark”-un).
- Një tjetër tregues që duhet parështë kostoja e ndërrimit të furnizuesit, deri në masën që konsumatorët fundorë janë në gjendje të ndryshojnë dot furnizues dhe nëse tregu e favorizon një gjë të tillë.
- Mbikqyrja në përgjithësi e sjelljeve të pjesëmarrësve të tregut, sipas raportimeve ditore pas mbylljes të tregut të ditës në avancë dhe atij balancues.

Ka edhe të tjera, por, këto që thamë nuk do të ishin keq si fillim.

Zakonisht, përveç të drejtave që u jep Ligji, rregullatorët e përdorin tagrin që kanë për monitorimin e tregut që tek detyrimet e licencave që lëshohen ndaj Shoqërive që ofrojnë shërbime në treg. Shtrirja e këtij tagri duhet të analizohet më tej nga ERE bazuar në të dhënat e licencave që lëshohen. Normalisht, licencat vendosin detyrime të tilla ndaj mbajtësve të tyre që i bëjnë ata të sillen si duhet si dhe të paraqesin informacione periodike tek rregullatori që t'i mundësojë këtij të fundit monitorimin e funksionimit të tregut apo të aktivitetit të të licensuarit në përgjithësi (p.sh: për efekt të monitorimit të performancës).

Arësyeja kryesore (por jo e vetme) që ERE shqyrton informacionet e sjella nga të licensuarit është nëse i licensuari ka shkelur ndonjë nga kushtet e licencës apo po silltet në mënyrë të tillë që të ndikojë negativisht tregun apo interesin e klientëve (privatë, publikë apo industrialë).

Përdorimi gjithë burimeve të informacionit për monitorimin e tregut.

Rregullatorët zakonisht përdorin burime të ndryshme informacioni për të kryer monitorimin e tregut. ERE do të përballojë flukse të tilla informacioni sin ë vijim:

Të dhënat e paraqitura në mënyrë periodike nga të licencuarit (kryesisht nga operatorët e rrjetit) si dhe raportime të tjera.

Shqyrtimi i ankesave (si nga klientët, ashtu edhe nga të licencuarit)

Vizitat në objekt

Mjetet e mas medias (radio, TV, gazeta, internet)

Kostot e ndryshimit të furnizuesit

Kqyrja e zhvillimeve në tregjet konkurruese dhe të hapura, njëkohësisht me rritjen e numrit të transaksioneve në bursën Shqiptare të energjisë, me qëllim shmangien e sjelljeve monopolistike.

Në vijim do të flasim për përjasjen e ERE-s ndaj mënyrës së trajtimit të informacionit të ardhur nga burimet e mësipërme.

Raportet periodike

ERE duhet të konsiderojë kostot që shkakton mbledhja dhe raportimi i informacionit të monitorimit të tregut tek të licencuarit, aftësia e tyre për ta mbledhur një informacion të tillë si dhe aftësia e ERE-s për ta analizuar. Mendohet që operatorët të jenë në gjendje t'i përmbushin këto kërkesa. Vendosija e kërkesave të tepërta që s'mund të përmbushen nga të licencuarit apo të shqyrtohen nga ERE në një periudhë afatshkurtër, do të krijonte një kulturë raportimi fallco.

Ankesat, vizitat në objekt si dhe mjetet e informimit publik.

Në parim, shqyrtimi i ankesave inicohet nga publiku (klientët fundorë) të shqetësuar nga gabimet e ofruesve të shërbimit. ERE vendos të ngrerë ekipe shqyrtimi ankesash të përhershëm apo rast pas rasti (ad-hoc) që do të specializohen në shqyrtimin e ankesave të ardhura nga publiku apo të bëra prezente nga mjetet e informimit publik.

ERE mundet gjithashtu të shkojë në objekt me qëllim hetimin e çështjes sa herë që del e nevojshme (p.sh: në rast se informacioni i ardhur nuk është i mjaftueshëm). ERE gjithashtu mund të vendosë një sërë rregullash të veçanta nëpërmjet të cilave të sanksionojë vizita të rregullta (periodike) gjatë vitit apo të veçanta (sipas rastit) në objekt dhe të marrë kontakte me personat përgjegjës.

Kostoja e ndërrimit të furnizuesit:

Qëllimi i ngritjes së tregjeve konkurruese është plotësimi i nevojave të klientëve me kosto sa më të ulët dhe cilësi sa më të lartë. Në tregjet me konkurrencë perfekte, klientëve duhet t'u

mundësohet që lirisht të zgjedhin furnizuesin me shërbim cilësor. Si rrjedhojë, prodhuesit apo furnizuesit bëjnë çdo përpjekje për të mbajtur klientët egzistues, si dhe të ardhurat e gjeneruara prej tyre.

Në tregjet jokonkurrues, është e vështirë, madje pothuajse e pamundur që një klient të ndryshojë prodhuesin e apo furnizuesin e mallit apo shërbimit. Për këtë arsye, një nga aspektet më të rëndësishme të monitorimit të tregut nga ERE duhet të jetë kostoja e ndryshimit të furnizuesit. Me vendosjen e një tregu konkurrues, ndryshimi i furnizuesit duhet të jetë praktikë normale, veçanërisht në rastin e klientëve të mëdhenj industrial (prodhim, shpërndarje), shërbimet (hotele & restaurante) si dhe subjekte publike (spitale, bashki e komuna). Kqyrja e kostove të ndryshimit të furnizuesit tregon shenjat e para të shmangies së konkurrencës, ndaj ERE duhet të marrë masat e nevojshme që kjo të mos ndodhë.

Monitorimi rregullt i tregjeve konkurrues:

Tregjet e zhvilluara ku mbizotëron konkurrenca e lirë janë gjithashtu subjekte monitorimi nga ana e rregullatorëve. Kjo vjen zakonisht në forma të tilla si kqyrja e trendës së çmimeve, sasisë apo përqëndrimit të tregut në tregun e ditës në avancë, tregun ditor dhe atë balancues.

Në rastin e Shqipërisë parashikohet që për një periudhë të caktuar kohe pjesa që zë një treg I tillë në volumin e përgjithshëm të energjisë që tregtohet do të jetë e papërfilshme. Pavarësisht kësaj, monitorimi i këtij tregu është i domosdoshëm me qëllim të identifikimit të shenjave të para të problemeve të funksionimit të tregjeve. Marrim rastin e numrit tejet të vogël të transaksioneve në një segment të caktuar tregu na bën të mendojmë që egzistojnë disa pengesa hyrjeje në treg të operatorëve. Gjithashtu, dominimi i tregut nga një operator I vetëm (apo një sasi e kufizuar operatorësh) tregon mundësinë gjithnjë e në rritje të monopolizimit të tregut që në fazat fillestare të funksionimit të tij.

Konsulentët kanë shqyrtuar format e rregullta të raportimit që përdoren nga ERE dhe kanë dhënë komente të hollësishme në lidhje me mundësinë e zbatimit të tyre në dobi të procesit të monitorimit të tregut nga ERE duke dhënë gjithashtu propozime për ndryshimin e tyre. Komente të detajuara në format e raportimit të dhënave paraqiten në anekset 1 & 2, ndërkohë që propozimet për ndryshimet përkatëse janë paraqitur në aneksin 3.

Kufizimi i informacionit:

Rregullatorët do të vuajnë gjithnjë nga fenomeni i asimetrisë së informacionit, pasi Shoqëritë e licensuara kanë më tepër informacion dhe njohuri në lidhje me biznesin e tyre se rregullatori do të mundet të ketë ndonjëherë. Si rrjedhojë, ERE do të jetë gjithnjë e varur nga informacioni që i vihet në dispozicion nga të licensuarit apo të tretët në procesin e vendimmarrjes.

Nisur nga sa thamë, për sa kohë që ERE bën maksimumin e mundshëm në kryerjen e detyrave të saj (mbledhja e vazhdueshme e informacionit të nevojshëm dhe shqyrtimi i tij), ajo nuk duhet bërë me faj nëse procesi i monitorimit që ajo kryen të mos arrijë të dallojë gabimet apo pasaktësitë.

Në mënyrë të ngjashme, ERE varet gjithashtu nga të tjerë (autoritete, ministri, zyra statistike, auditues financiarë apo edhe gazetarë që janë në kryerje të detyrave të tyre me përkushtim). Përderisa pasaktësitë nuk janë "vezulluese" (bëjnë mu...), nuk është përgjegjësi e ERE-s të gjykojë vërtetësinë e informacionit që i vihet në dispozicion. Në fakt ERE ka detyrimin të mbledhë dhe analizojë të dhëna, dhe në rast se vëreën ndonjë pasaktësi, të hetojë dhe veprojë në mënyrën e duhur.

Aspekti rajonal:

Në Shqipëri është shumë e rëndësishme që shërbimeve të ofruara nga Shoqëritë që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike të jenë cilësore dhe me një çmim të arësyeshëm, ndaj ato rregullohen nga ERE. Operimi efektiv i tregut Shqiptar të energjisë elektrike, që planifikohet të zhvillohet në një treg rajonal ndërmjet Shqipërisë, Kosovës e më gjerë, bën të mundur që pjesëmarrësit që janë konkurrues në tregun e brendshëm të energjisë elektrike në Shqipëri të jenë të tillë edhe në një treg rajonal.

Planifikimii kujdesshëm i burimeve:

Një vështrim i përgjithshëm i kërkesave të ligji për sektorin tregon se ERE-s do t'i duhet:

Të ndërtojë një plan të rregullt për kryerjen e detyrave që i cakton Ligji (p.sh: forma e të dhënave të kërkuara; Rportime të rregullta të monitorimit të tregut, mjetet e informimit public, apo vizita të rregullta apo me qëllim të veçantë)

Të identifikojë burimet njerëzore dhe kualifikimet e nevojshme për ta. Si fillim, më së pakti dy anëtarë të stafit duhet të trajnohen në këtë fushë. Ata do të duhet të ndërtojnë sistemin e duhur për monitorimin e tregut. Për satë jetë e mundur, ERE duhet të automatizojë sistemin dhe të ndërtojë një bazë të dhënash të besueshme për qëllime të monitorimit të tregut, që, më tej mund të ndihmojë në krijimin e bursës së energjisë

Siguron burimet, zbaton planin, monitoron rregullisht si dhe raporton në lidhje me zbatimin e planit.

Udhëzime për monitorimin e tregut:

Monitorimii tregut kërkon një vlerësim të gjerë të sjelljes së pjesëmarrësve në të (si sjelljen aktuale, ashtu edhe atë të pritshme). Duhet të bëjë përpjekje të veçanta për të shquar ata pjesëmarrës që duket sikur u shijon fuqia dominuese në treg.

Me identifikimin e sjelljeve negative apo jokonkurrese, ERE duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për eliminimin e tyre, duke filluar nëpërmjet njoftimeve të rregullta, udhëzimeve apo urdhërave të bazuara në ligj, e më tej në vendosje penaltetesh.

Konsulentët kanë shqyrtuar format e rregullta të raportimit që përdoren nga ERE dhe kanë dhënë komente të hollësishme në lidhje me mundësinë e zbatimit të tyre në dobi të procesit të monitorimit të tregut nga ERE duke dhënë gjithashtu propozime për ndryshimin e tyre. Komente të detajuara në format e raportimit të të dhënave paraqiten në anekset 1 & 2, ndërkohë që propozimet për ndryshimet përkatëse janë paraqitur në aneksin 3.

Në çdo rast, edhe në ato të mosidentifikimit të menjëhershëm të sjelljeve jokonkurrese gjatë monitorimit, rregullatori duhet që gjithnjë të kërkojë efikasitet gjithnjë e në rritje të tregut të energjisë elektrike si dhe rritje të konkurrencës, pasi kjo është menyra më e mirë për t'u siguruar një buxhetim sa më të mirë për klienteët fundorë.

Në këtë kapitull, konsulentët e RTI dalluan aspekte të veçanta ku ERE duhet të përqëndrohet në monitorimin e tregut, me qëllim zhvillimin e tregut të energjisë në Shqipëri.

Monitorimii tregut në lidhje me sjelljet jokonkurrese:

Rregullatori duhet të përqëndrohet në dy drejtime kryesore për të identifikuar praninë e sjelljeve jokonkurrese. Këto janë kqyrja e sjelljes së monopoleve natyrorë (kryesisht operatorëve të rrethit) si dhe abuzimeve pozitën tashmë dominuese në tregjet fillimisht konkurrese.

Deri sat ë dallohet ndonjë ndikim negativ nga pjesëmarrësit e tregut, rregullatori duhet të marrë të gjitha masat për ndalimin e vazhdimin të këtij impakti negative nga ana e tyre.

Monitorimii operatorëve të rrjetit:

Diskriminimi nga operatorët e rrjetit e ndikon në shumë mënyra konkurrencën, ku më e dëmshme është ajo që, në sajë të veprimeve apo mosveprimeve të një operatori të caktuar rrjeti, disa burime gjeneruese që mund të ishin konkurrese në treg, përjashtohen nga ky I fundit.

Ndodhja e shpeshtë e kongjestionëve apo drejtimeve të detyruara janë raste tipike të sjelljeve jo të duhura të operatorëve të rrjetit. Operatorët e rrjetit mund të kenë shumë arsye për të diskriminuar disa burime gjeneruese. P.sh: për sa kohë këta gjenerues nuk janë pjesë e ndonjë structure vertikale, ata kanë shumë gjasa të diskriminojnë konkurrentët potencialë në favor të atyre që I përkasin ndonjë Shoqërie simotër. Padyshim, sipas rregullave të tregut të BE/KE, ku të paktën ndarja formale e rrjetit nga gjenerimi është bërë kohë më parë, ky shqetësim eliminohet. Sidoqoftë, me ndryshimet e fundit teknologjike (veçanërisht burimet e reja gjeneruese të

energji të rinovueshme të lidhura në shpërndarje që mbështesin operacionet lokale të rrjetit, apo sistemet e baterive), rastet ku operatorët e rrjetit do të rihyjnë në ndonjë formë aktiviteti gjenerues apo paragjenerues do të jenë gjithnjë e më të shpeshta, prandaj mbikqyrja e rregullatorit në këtë drejtim duhet të ende të egzistojë.

Një arsye tjetër e abuzimit të pushtetit monopolistic natyror të një operatori rrjeti mund të vijë nga pjesëmarrja e tyre në kontrata shitblerjeje afatgjata apo marrëveshjet e daljes. Kuptohet që ky është rasti I sotëm I Shqipërisë, ku prodhuesit nga burimet e rinovueshme kanë kontrata blerjeje afatgjata me operatorët e rrjetit.

Së fundmi, operatorët e rrjetit tentojnë të shmangin zgjerimin dhe investimet në zona që ata I konsiderojnë problematike (të kushtueshme). Kjo ndofta vjen si pasojë e çështjeve të “së drejtës së kalimit”, fondeve të pamjaftueshme për investime, etj...

Monitorimii përqëndrimit të tregut:

Tregjet e monopolizuara kryesisht rezultojnë me kosto më të mëdha për konsumatorin fundor. Rregullatorët (si ata të autoritetit të konkurrencës, ashtu edhe atateinfrastrukturës ekonomike) duhet të mbikqyrin përqëndrimin e tregut dhe të marrin masa për të ndaluar abuzimin e fuqisë dominuese në treg nga Shoqëritë e mëdha.

Një nga treguesit më të përhapur për matjen e konkurrencës në treg është treguesi HHI.

HapiI parë për matjen e HHI-së ka të bëjë me pjesën në një treg të caktuar të çdo pjesëmarrësi, në rastin tonë tregu I ditës në avancë. Me këtë llogjikë secila pjesë vihet në rrënjë katrore dhe bëhet shumatorja e këtyre rrënjëve katrore që është një shifër ndërmjet 0 dhe 10,000.

Sa më afër zeros të jetë kjo vlerë, aq më konkurrues është tregu mbi të cilin është kryer llogaritja. Sa më afër 10,000 të jetë kjo llogaritje, aq më monopol është ky treg. Rregullatorët të ndryshëm kanë vlera të ndryshme të HHI, duke bërë të nevojshme futjen e masave antimonopoly por, në përgjithësi, vlera të tilla të indeksit HHI më të mëdha se 1,600 apo 1,800 tregojnë shmangie të konkurrencës në këtë treg.

Me qëllim marrjen e informacionit të nevojshëm për llogaritjen e indeksit HHI, ERE mund të shfrytëzojë një nga këto dy burime:

Të ardhurat e Shoqërive nga prodhimi apo shitja e energjisë dhe pastaj pjesa që zënë këto të ardhura në ato të të gjithë Shoqërive të së njëjtës natyrë në treg.

Informacion nga bursa e energjisë sapo të fillojë procesiI tregtimit.

Vlerësimii çmimit të energjisë elektrike.

Një aspect tjetër që rregullatori duhet të mbikqyrë, veçanërisht në zona ku tregjet e hapura dhe konkurrese janë në faza zhvillimore, sin ë Shqipëri, është edhe çmimiI energjisë. Kjo ka të bëjë

me atë nëse çmimet që pguajnë klientët fundorë të mos jenë dukshëm më të larta se ato që paguajnë këta klientë në rajone të ngjashme. Natyrisht ky krahasim (benchmarking) nuk është kurrë perfekt për faktin se është mjaft e vështirë të gjenden dy rajone me të njëjtat karakteristika portofoli energjie, kushte terreni, apo zhvillimi ekonomik apo masëinvestimesh.

Çmime dukshëm të larta të cilat vazhdojnë për një kohë relativisht të gjatë dhe që gjenerojnë perfitime të larta të paarësyeshme për disa pjesëmarrës tregu tregon që këta pjesëmarrës po abuzojnë me pozicionin e tyre dominues në treg.


Pavarësisht dobësive, krahasimi i çmimit (benchmarking) është shumë i përhapur dhe KE dhe ACER publikojnë rregullisht raporte tremujore mbi tregjet e energjisë elektrike në BE, gjë që bën të mundur krahasimin ndërmjet tyre.

Gjithashtu publikohen raporte vjetore me informacione më të hollësishme jo vetëm mbi çmimet. Së fundmi u publikua “Raporti vjetor mbi rezultatet e monitorimit të tregjeve të brendshme të energjisë elektrike dhe gazit në 2016”. Vërehet që, ndërsa Shqipëria I afrohet pranimi në BE, ERE do të duhet të zbatojë sisteme monitorimi të tregut në përputhje me standartet e BE-së.

Procedurat për zbatim:

Proçesi:

Proçesii monitorimit të tregut, mbledhjes sëinformacionit, shqyrtimi dhe vendimmarrja në bazë tëinformacionit që kemiështë kompleks dhe kërkon kohën e vet, në varësi të llojit tëinformacionit në shqyrtim. Një vështrim I shkurtër mbi mbledhjen e informacionit dhe oroçesit të shqyrtimit të këtij informacioni për qëllim të monitorimit të tregut paraqitt në figurën 8-1.



Kemi dy pjesëmarrës të përfshirë në proçesin e monitorimit të tregut:

Pjesëmarrësit e tregut

Personeli ERE-s

Ndërsa pjesëmarrësit e tregut do të jenë kryesisht përgjegjës për sa I përket informacionit që ata japin si dhe zbatimit të udhëzimeve dhe vendimeve të rregullatorit, ERE duhet të përdorëinformacionin e marrë, raportimet e bëra, informacionin që jepet nga të tretët si dhe shqyrtimin e këtij informacioni për të mbështetur vendimmarrjen e saj për të konturuar legjislacionin e duhur sekondar, marrjen e vendimeve, vendosjen e penaliteteve, duke ndihmuar kështu konkurrencën në treg.

Rregullat për zbatim nga pjesëmarrësit e tregut:

Në fazën e parë Shoqëritë përgatisin të dhënat e nevojshme për qëllim të plotësimit tëinformacioneve peridike që paraqesin në ERE. Për sa kohë zbatohen afatet e vendosura nga ERE (3), ky prçes nuk do të përbëjë mëinteres për ERE-n, por do të jetë thjesht një çështje e

brendshme e Shoqërisë që raporton. Nëse hasen probleme në këtë drejtim, ERE mund të përdorë pushtetin e saj në lidhje me penalitetet e parashikuara në kushtet e liçencës apo ato të parashikuara në Ligj.

Nga perspektiva e vendosjes së sistemeve të monitorimit të tregut, Shoqërive të përfshira do t'u duhet të kenë personel të kualifikuar, të aftë të paraqesin informacionin e duhur në ERE, përfshirë edhe formatin në të cilin ERE mund t'i kërkojë këto të dhëna.

Organizimi i informacionit të monitorimit të tregut nga ERE si dhe vlerësimi i tij:

Faza e dytë përfshin mbledhjen nga ERE të informacionit organizativ, financiar dhe operacional dhe ndqet nga një fazë e tretë ku analizohet si informacioni i përgjithshëm, ashtu edhe ai specifik sipas kushteve të liçencës.

Para se të fillojë mbledhja e të dhënave dhe shqyrtimi i tyre, ERE duhet të fillojë të mbledhë burimet e duhura organizative dhe ato njerëzore për përpunimin dhe analizimin e të dhënave. Kjo do të kërkojë që disa analistë të menaxhohen nga qendra.

Për sa i takon personelit të ERE-s, në lidhje me monitorimin e tregut, mbledhjen e informacionit dhe përpunimin e tij, do ketë nevojë për këto pozicione pune:

- Drejtor drejtorie, përgjegjës për operimin e përditshëm dhe mbikqyrjen e funksionit të monitorimit të tregut
- Staf i drejtorisë që kryen mbledhjen dhe shqyrtimin e përditshëm të informacionit

Në terma të përgjithshëm, stafi i drejtorisë do të jetë në krye të mbledhjes së informacionit për efekt të monitorimit të tregut dhe do të jetë përgjegjës për hartimin e raporteve bazuar në shqyrtimin e këtij informacioni, duke plotësuar kërkesat e niveleve të tjera të menaxhimit në ERE, madje duhet të japë edhe rekomandime.

Zbatimi i rregullave dhe vendosja e penaliteteve nga ERE:

Nëse nga shqyrtimi dhe analizi i informacioneve del që duhen marrë masa dhe ERE vendos ta bëjë një gjë të tillë, kjo i përket fazës së katërt ku përfshihet lëshimi i urdhërave apo rekomandimeve ndaj Shoqërive bazuar në këto analiza. Në raste ekstreme, ERE mund ta shohë të nevojshme të vendosë penalitete për çdo pjesëmarrës tregu që thyen rregullat, në përputhje me parashikimet e nenit 107 të Ligjit.

Përmbajtja e kërkesave për informacion në lidhje me monitorimin e tregut:

Në këtë kapitull duhen marrë parasysh udhëzimet për proceset apo treguesit që rezultojnë të dobishëm në lidhje me zhvillimet aktuale në tregun e energjisë elektrike në Shqipëri, karakteristikat e tij si dhe përpjekjet në vazhdim (qëllimi afatgjatë i hyrjes në BE; bashkimi i tregjeve me Kosovën dhe, në të ardhmen edhe më gjerë, me tregjet e energjisë elektrike në Ballkan dhe në BE).

Kemi shqyrtuar gjithashtu format e zakonshme të raportimit në ERE si dhe kemi dhënë opinion tepër të detajuar në lidhje me rolin e tyre në procesin e monitorimit të tregut nga ERE, madje edhe kemi propozuar se si mund të rifreskohen. Komente me të hollësishme në lidhje me format e të dhënave që përdor ERE aktualisht gjenden në Aneksin 1 & 2, ndërsa format shtesë të propozuara që rifreskojnë procesin e mbledhjes së të dhënave janë në aneksin 3.

Mënyra e mbledhjes së informacionit:

Ky kapitull përmban një shpjegim në lidhje me një sërë propozimesh për format e gatshme që tregojnë propozimin për sistemin e monitorimit të tregut të energjisë elektrike nga ERE. Këto forma janë konturuar në dy kategori kryesore:

Një sërë formash që mundësojnë ERE-s të mbledhë të dhëna të përgjithshme mbi të licencuarit (përputhshmëria, sa herë që të jetë e mundur, nëse janë ndjekur standartet e vendosura në format e mbledhjes së të dhënave që aplikohen aktualisht nga ERE dhe/ose ACER) dhe që përfshijnë:

Të dhënat e kontaktit dhe kontaktet e personave që raportojnë rregullisht

Qëllimi i kësaj është që t'i mundësojë ERE-s adresën e saktë me të cilën do shkëmbejë korrespondencë

Raporti i kërkuar nga kontakti sipas adresës (Aneksi 3)

Përbërja e drejtimit dhe bordit:

Në periudha afatshkurtra identifikohen personat që janë përgjegjës në marrjen e vendimeve të rëndësishme të licencuarit. Në periudha afatgjata, ERE mund të dojë të vendosë marrëdhënie (qoftë edhe jozyrtare) ndërmjet operatorëve nën kujdesin e saj, në mënyrë që të mund të identifikojë sa më lehtësisht shkeljet (ushtrimi i fuqisë së ndjeshme nëpërmjet disa Shoqërive me të njëjtin pronar)

Forma e propozuar e raportimit "Përbërja e Bordit dhe Drejtuesit" e zgjidh këtë shqetësim.

